



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr.1035/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit Auto Taxi B.K., me NUI: 810609604, me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.O., avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “SIGMA”, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.M., avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 10,102.36 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 21.11.2023, në prani të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurit, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Auto Taxi B.K. dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “SIGMA”, që në emër të dëmit material, si pasojë e dëmeve të shkaktuara në aksidentin e datës 15.09.2012, të ia paguaj paditësit shumën prej 6,227.90 € (gjashtë mijë e dyqind e njëzet e shtatë euro e nëntëdhjetë cent) dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 843.73 € (tetëqind e katërdhjetë e tri euro e shtatëdhjetë e tri cent) me kamatë ligjore në lartësi prej 12% të interesit vjetor, nga data e paraqitjes së padisë 15.09.2012, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit.
- II. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Auto Taxi B.K. përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për shumën prej 2,669.10 €, në emër të kompensimit të dëmit dhe shumën prej 361.63 € në emër të fitimit të humbur.
- III. DETYROHET i padituri që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 2,977.94 € (dy mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e nëntëdhjetë e katër cent), në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësi Auto Taxi B.K., me datën 04.04.2013, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "SIGMA", me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "SIGMA", që paditësit për dëmin e shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit të datës 15.09.2012 të ia paguajë shumën prej 10,102.36 €, me kamatë ligjore në lartësi prej 12% të interesit vjetor, duke filluar nga dita e aksidentit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, me Aktgjykimin C.nr.170/2013 të datës 22.12.2017 në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka detyruar të paditurin që palës paditëse të ia paguaj në emër të kompensimit të dëmit material shumën prej 8,897.00 € dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 1,205.36 €, me kamatë ligjore prej 12 %, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë 04.04.2013 e deri në pagesën definitive, në afatin parativ prej 7 ditëve. Ndërsa në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura që të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore paditësit në shumën prej 1,827.00 €.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vendosur në procedurën ankimore sipas ankesës të palës së paditur, me aktvendimin Ae. nr.50/2018, të datës 24.10.2019, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës, duke e vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.170/2013 të datës 22.12.2017.

Gjykata Supreme e Kosovës duke vendosur në procedurën e revizionit të paditurës, me Aktvendimin E.Rev nr. 67/2019 të datës 26.11.2020 e ka pranuar si të bazuar revizionin e të paditurës dhe ka prishur Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.50/2018 të datës 24.10.2019 dhe të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike C.nr.170/2013 të datës 22.12.2017, duke ia kthyer lëndën gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përfaqësuesi i paditësit në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj, duke shtuar se nga ekspertiza e makinerisë e përpiluar gjatë kësaj procedure, është vërtetuar përgjegjësia e veturës C si

kontribues në aksidentin e datës 15.09.2012 dhe se në rastin konkret kemi të bëjmë me një çështje nga Ligji Për Sigurimin e Detyrueshëm Nga Auto përgjegjësia (Ligji Nr. 04/L-018) ku sipas nenit 3 është paraparë që palës së dëmtuar si pasojë e shkaktimit të dëmit, nga makina tërheqëse ose me rimorkio, i takon e drejta e kompensimit në tërësi.

Nga ekspertiza dhe sqarimet e grupit të ekspertëve paditësi ka theksuar që është vërtetuar përgjegjësia e të paditurës lidhur me aksidentin si dhe pas administrimit të provës nga ekspertiza financiare si dhe ekspertizës lidhur me fitimin e humbur është vërtetuar dëmi total në shumën prej 10,102.36 €. Andaj duke qenë se shkaktari i aksidentit ka qenë vetura “A”, e cila është e siguruar pranë të paditurës, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara pjesërisht është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë dhe atë përgjegjësia e të paditurit, duke theksuar se në bazë të ekspertizës së fundit të punuar nga grupi i ekspertëve të makinerisë përgjegjësia mbi të siguruararin si palë e paditur është në shkallën prej 60%, ndërsa për paditësin 40%, duke theksuar se janë të gatshëm që për këtë çështje, palës së dëmtuar në përpjesëtim me përgjegjësinë ti ofrojnë shumën prej 6,227.00 €. Në lidhje me përlllogaritjen e kamatës ka shtuar se duhet të zbatohet ligji i vjetër në kohën kur ka ndodhur aksidenti. Ka shtuar se nga ekspertiza e komunikacionit janë konstatuar lëshimet e pjesëmarrësve në aksidentin e trafikut dhe kontributet e tyre në rastin konkret. I ka propozuar Gjykatës që lidhur me kërkesëpadinë e paditësit të vendos në përpjesëtim të përgjegjësisë të palëve ndërgjyqëse. Sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore, ka theksuar që gjykata duhet të marr për bazë parimin e suksesit në procedurë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor bëri administrimin e provave si në vijim: Ekspertiza e komunikacionit e datës 13.12.2021 e hartuar nga eksperti Z. S.B.; Ekspertiza për lartësinë e dëmit në automjetet e datës 23.01.2014 e hartuar nga eksperti Z. Y.K; Ekspertiza financiare e datës 27.05.2014 e hartuar nga eksperti Z. A.K.; Raporti i aksidentit 2012/GR17907 e datës 15.09.2012 si dhe Ekspertiza e komunikacionit e datës 25.10.2023 e hartuar nga grupi i ekspertëve Z. A.M, ZNJ. A.RR. dhe B.A..

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

Në rastin konkret për asnjërën palë ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se automjeti i markës “MERCEDES”, me numër të targave të regjistrimit ` , pronë e Auto Taxi B.K., ka qenë i siguruar tek i padituri, gjë e cila është provuar edhe me anë të policës së sigurimit të automjeteve 210577.

Po ashtu nuk është kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse se gjatë periudhës siguruese me datën 15.09.2012, në Magjistralen Prizren - Prishtinë, përkatësisht në Qafë të Duhlës është shkaktuar aksidenti automobilistik, me ç’rast veturës së paditësit i është shkaktuar dëm material.

Në rastin konkret, kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte lartësia e kompensimit të dëmit, përkatësisht nëse e paditura është përgjegjëse për kompensimin e tërësishëm të dëmit material dhe fitimit të humbur, apo përgjegjësia për kompensimin e dëmit është e ndarë.

Nga ekspertiza e komunikacionit e përpiluar nga eksperti Z. S.B, të datës 13.12.2021, është konstatuar që me datën 15.09.2012, rreth orës 06:40 në vendin e ashtuquajtur “Qafa e Duhlës”, Komuna e Suharekës, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit me lëndime të lehta, të rënda, vdekjeprurëse dhe me dëme të mëdha materiale. Eksperti ka konstatuar që ngasësi “A”, i kamionit “Scania”, M.L., i siguruar tek e paditura ka qenë shkaktar i aksidentit (primar), ngasësi “B” i veturës Mercedes, paditësi Auto Taxi B.K., nuk i ka dhënë kontribut aksidentit dhe ngasësi “C”, i veturës VW Polo V.M., i siguruar tek Kompania e Sigurimeve “Sigal”, i ka dhënë kontribut sekondar aksidentit.

Nga ekspertiza për lartësinë e dëmit në automjet e datës 23.01.2014 e hartuar nga eksperti Z. Y.K., është konstatuar që dëmi i shkaktuar në veturën “MERCEDES” të paditësit, si pasojë e aksidentit në komunikacion ka qenë në vlerën prej 8,897.00 €.

Nga Ekspertiza financiare e datës 27.05.2014 e hartuar nga eksperti Z. A.K., është konstatuar se pagesa e fitimit neto të humbur si pasojë e pamundësisë së zhvillimit të veprimtarisë afariste të paditësit, arrin në shumën prej 1,205.36 €.

Nga ekspertiza e komunikacionit e përpiluar nga grupi i ekspertëve Z. A.M., Znj. A.Rr. dhe Z. B.A. të datës 25.10.2023, është konstatuar që deri te aksidenti i komunikacionit rrugor ka ardhur nga lëshimet e bëra nga ana e drejtuesit të automjetit “A” përkatësisht Automjetit Transportues “Scania”, me targa të regjistrimit ... me drejtues M.L., i cili është shkaktar i këtij aksidenti meqenëse i njëjti nuk ka pasur kujdes të shtuar në atë pjesë të rrugës, duke kaluar në shiritin e kahjes së kundërt, ku me pjesën anësore të majtë të rimorkios e godet automjetin “B”, përkatësisht Automjetin Mercedes me targa të regjistrimit ... me drejtues B.K., në pjesën e përparme të anës së majtë, ndërsa këtij aksidenti i ka kontribuar edhe drejtuesi i automjetit “C”, përkatësisht Automjeti “VW Polo”, me targa të regjistrimit ..., me drejtues V.M., meqenëse i njëjti nuk ka pasur kujdes të shtuar në atë pjesë të rrugës dhe me rastin e paraqitjes së rrezikut në rrugë, nuk ka arritur që ta ndalë automjetin, ku me pjesën e përparme të anës së djathtë e godet automjetin “B”, në pjesën e pasme të anës së majtë. Ndërsa drejtuesi i automjetit “B”, nuk ka pasur asnjë lëshim lidhur me këtë aksident.

Me nenin 178 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD 1978), përcaktohet se *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesiseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullate mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë. Në qoftë se ekziston faji dypalësh, secili zotërues përgjigjet për dëmin total që e kanë pësuar ata përpjestimisht me shkallën e fajësisë së tyre. Në qoftë se nuk ka fajsi në asnjë anë zotëruesit përgjigjen në pjesë të barabarta në qoftë se shkaqet e drejtërisë nuk kërkojnë gjë tjetër. Për dëmin që e kanë pësuar personat e tretë zotëruesit e automjeteve përgjigjen solidarisht.”*

Gjykata nga gjendja faktike e vërtetuar, përkatësisht nga konstatimet e ekspertit z. S.B. dhe grupit të ekspertëve z. A.M., Znj. A.Rr. dhe Z. B.A., vlerëson se në rastin konkret përgjegjësia për shkaktimin e dëmeve si pasojë e aksidentit të komunikacionit është e ndarë dhe se të paditurit i takon përgjegjësia për 70 %, të kompensimit të dëmit, meqenëse nga lëshimet e të siguruarit të të paditurës ka ardhur deri te aksidenti i komunikacionit, të cilave ekspertiza gjykata ja u fali besimin, meqenëse të njëjtat janë punuar sipas standardeve profesionale duke u mbështetur në shkresat e lëndës

Ndërsa duke u bazuar në konstatimet e ekspertit Y.K., sa i përket lartësisë së dëmit në automjet dhe ekspertizës financiare të ekspertit z. A.K., sa i përket fitimit të humbur të paditësit, gjykata në bazë të përgjegjësisë së ndarë, vlerëson se paditësit nga shuma e kërkuar prej 8,897.00 € në emër të kompensimit të dëmit i takon shuma prej 6,227.90 €, ndërsa për fitimin e humbur nga shuma e kërkuar prej 1205,36 €, i takon shuma prej 843.73 €. Gjykata po ashtu ia fali besimin në tërësi ekspertizave të lartcekura, meqenëse të njëjtat janë punuar në mënyrë profesionale e po ashtu nuk kanë qenë kontestuese as nga palët ndërgjyqëse.

Gjykata këtë vlerësim e ka bazuar edhe në dispozitat e nenit 189 të LMD-së (1978), me të cilën përcaktohet se *“I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar. Shuma e dëmit të thjeshtë caktohet sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor me përjashtim të rastit kur ligji urdhron diçka tjetër. Gjatë vlerësimit të shumës së perfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi. Kur sendi është asgjësuar ose është dëmtuar për shkak të veprës penale të kryer me dashje gjykata mund të caktojë shumën e kompensimit sipas vlerës që ka pasur sendi për të dëmtuarin.”*

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit, përtej shumës së gjykuar si në pikën I dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për shumën prej 2,669.10 €, në emër të kompensimit të dëmit dhe shumën prej 361.63 € në emër të fitimit të humbur, meqenëse në rastin konkret nga gjendja faktike e vërtetuar, rezulton se përgjegjësia për kompensimin e dëmit ishte e ndarë dhe se të paditurit i takon përgjegjësia prej 70 % të kompensimit të dëmit, pasi që në këtë rast kontribut sekondar në shkaktimin e dëmit material ka dhënë edhe ngasësi i veturës “VW Polo” me targa të regjistrimit, me drejtues V.M., i cili ka qenë i siguruar tek Kompania e Sigurimeve “Sigal”.

Gjykata duke iu referuar nenit 26 pika 6 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, në bazë të së cilit përcaktohet se *“Në rast të mosrespektimit të afateve të përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni, dhe mos përmbushjes së detyrimit në pagesën e paradhënies nga paragrafi 4. i këtij neni, siguruesi përgjegjës konsiderohet të jetë në vonesë në përmbushjen e detyrimit për dëmshpërblim, duke u ngarkuar me pagesë të interesit për vonesë. Ky interes paguhet në lartësi prej 12 % të interesit vjetor dhe llogaritet për çdo ditë*

vonesë deri në shlyerjen e dëmshpërblimit nga siguruesi përgjegjës, duke filluar nga data e paraqitjes së kërkesës për dëmshpërblim” e miratoi kamatëvonesën e kërkuar, duke e detyruar të paditurin që paditësit t’ia paguajë edhe kamatën ligjore prej 12 % në vit, duke filluar nga data 15.09.2012 e deri në pagesën definitive.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.2 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së precizuar si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga paditësi dhe atë për përpilimin e padisë në shumën prej 104.00 €, për përfaqësim në 10 (dhjetë) seanca të mbajtura (270.40 € x 10) dhe 1 (një) seancë të shtyer (135.20 € x 1) në shumën prej 2,879.20 €, në emër të pagesës për ekspertizën financiare shumën prej 350.00 €, në emër të pagesës së grupit të ekspertëve në shumën prej 900.00 €, si dhe taksës gjyqësore në shumën prej 21.00 €, gjithsej shumën totale prej 4,254.20 €, e për lartësinë e të cilës i padituri është obliguar që ti paguaj në mënyrë proporcionale me suksesin e arritur në procedurë, gjithsej shumën prej 2,977.94 €.

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.1035/22, datë 21.11.2023.

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.